



UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

STRATEGJIA PËR SIGURIMIN E CILËSISË 2026 – 2030¹

¹ Miratuar me Vendim Senati Nr. 13, datë 15/05 /2026



PËRMBAJTJA	
HYRJE.....	2
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
1.1. Qëllimi dhe baza ligjore	2
1.2. Vizioni dhe misioni i institucionit	2
POLITIKA PËR SIGURIMIN E CILËSISË	3
2.1. Objektivat strategjikë.....	3
2.2. Parimet e menaxhimit të cilësisë.....	3
2.1. Standardet e sigurimit të cilësisë	4
SISTEMI I SIGURIMIT TË CILËSISË	5
3.1 Organizimi i sistemit.....	5
3.2 Qasja PDCA.....	6
3.3 Qëllimet e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	6
3.4 Objektivat kryesore të sistemit.....	6
3.5 Dokumentet kryesore të sistemit.....	7
3.6 Organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional	7
3.7 Organe, autoritete dhe struktura në nivel të njësive kryesore dhe bazë.....	9
3.8 Struktura ndihmës-akademike dhe administrative	10
VLERËSIMI, MONITORIMI DHE PËRMIRËSIMI I CILËSISË	10
RAPORTIMI, TRANSPARENCA DHE ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE.....	12
SIGURIMI I JASHTËM I CILËSISË DHE AKREDITIMI.....	14
DISPOZITA TË FUNDIT	14

HYRJE

Universiteti Europian i Tiranës (UET) është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në Shtator, 2006 (VKM Nr. 636, datë 20.09.2006) dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore që zbatohen në fushën e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. UET ofron programe studimit në të tre ciklet e studimit, si dhe programe të studimit me karakter profesional, në fushat dhe nëndisiplinat; shkenca ekonomike, shkenca juridike, shkenca sociale e politike, shkenca humane e arte të aplikuara, shkenca inxhinierike e të teknologjisë së informacionit, shkenca mjekësore teknike.

Veprimtaria e UET mbështetet nga strukturat akademike dhe administrative të tij, sipas detyrave dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të funksionit të tij. Universiteti Europian i Tiranës, i kushton rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë, në të dy komponentët e këtij procesi - sigurimit të brendshëm dhe sigurimit të jashtëm të cilësisë. UET e ndërton veprimtarinë e tij për sigurimin e cilësisë bazuar në Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë (në vijim edhe; Strategjia SC).

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1. Qëllimi dhe baza ligjore

Strategjia për Sigurimin e Cilësisë është dokument refererimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe marrëdhënieve të universitetit me institucione dhe aktorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë.

Qëllimi i Strategjisë SC është organizimi dhe funksionimi efektiv i Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me synim garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në veprimtarinë akademike, kërkimore, studentore, administrative dhe institucionale. Strategjia SC synon të forcojë kulturën e cilësisë, vendimmarrjen e bazuar në evidenca, transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen aktive të studentëve, stafit akademik, stafit administrativ dhe palëve të tjera të interesuara.

Strategjia për Sigurimin e Cilësisë bazohet në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", akteve nënligjore në zbatim të tij, Kodin e Cilësisë, standardet dhe udhëzuesit për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (European Standard and Guidelines, ESG 2015), Statutin dhe Rregulloren e UET.

1.2. Vizioni dhe misioni i institucionit

Vizioni i Institucionit

Vizioni i UET është të jetë lider i arsimit të lartë në Shqipëri, me ndikim të dukshëm në fushën e edukimit, shkencës, inovacionit dhe ndryshimeve të sotme shoqërore, i aftë për t'u përsosur vazhdimisht dhe përshtatur me dinamikën e ndryshimeve të shpejta të zhvillimit ekonomik dhe social të shoqërisë shqiptare dhe përtej saj, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me partnerë lokalë dhe ndërkombëtare për zhvillimin e dijes, shkencës dhe teknologjisë, për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të së mirës së përbashkët.

Misioni

Të ofrojë një pol alternativ në sektorin e arsimit të lartë shqiptar, edukim cilësor të mbështetur në praktikat më të mira, bashkëkohore të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit, me qëllim aftësimin e studentëve të tij me të gjitha kompetencat e nevojshme që kërkon dinamika e tregut të punës, të cilët do të jenë profesionistë dhe drejtues të së ardhmes, me impakt në zhvillimet

ekonomike dhe shoqërore. UET udhëhiqet nga standardet europiane të cilësisë, nxit integrimin e dijes teorike me zbatimin praktik të saj, kërkimin shkencor aplikativ, ndërkombëtarizimin, dhe përfshirjen aktive të studentëve në procesin e mësimdhënies (student-centred learning), vendimmarrjes dhe projektet kërkimore.

KREU II POLITIKA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Politika për Sigurimin e Cilësisë, është tërësia e qëllimeve, parimeve dhe rregullave që i përmbahet UET për vendimmarrjen dhe planifikimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij.

2.1. Objektivat strategjikë

- a. Forcimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë
Zhvillimi dhe konsolidimi i një sistemi efektiv, të integruar dhe të qëndrueshëm të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në përputhje me standardet kombëtare dhe europiane të arsimit të lartë.
- b. Zhvillimi i kulturës institucionale të cilësisë
Promovimi i kulturës së cilësisë, përgjegjshmërisë institucionale dhe përfshirjes aktive të stafit akademik, studentëve dhe aktorëve të tjerë të interesit në proceset e sigurimit të cilësisë.
- c. Përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit
Garantimi i monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, syllabuseve, rezultateve të të nxënit dhe metodologjive të mësimdhënies.
- d. Rritja e cilësisë së përvojës studentore
Përmirësimi i përvojës akademike dhe mbështetjes studentore përmes mekanizmave të feedback-ut, monitorimit të kënaqësisë studentore dhe promovimit të qasjes "studenti në qendër" (*student-centered learning*).
- e. Forcimi i vendimmarrjes së bazuar në evidencë
Rritja e përdorimit të të dhënave, indikatorëve institucionalë dhe analizave statistikore në proceset e monitorimit, planifikimit dhe vendimmarrjes institucionale.
- f. Rritja e efektivitetit të proceseve të monitorimit dhe vlerësimit
Zhvillimi i mekanizmave efektivë të monitorimit, vetëvlerësimit, auditimit të brendshëm dhe ndjekjes së planeve të përmirësimit institucional dhe akademik.
- g. Forcimi i bashkëpunimit me aktorët e interesit
Rritja e bashkëpunimit me studentët, alumni, punëdhënësit, partnerët institucionalë dhe ekspertët e jashtëm për përmirësimin e relevancës dhe cilësisë së programeve të studimit.
- h. Mbështetja e ndërkombëtarizimit dhe krahasueshmërisë akademike.
Nxitja e përputhshmërisë së proceseve akademike dhe të cilësisë me praktikat dhe standardet europiane dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.

2.2. Parimet e menaxhimit të cilësisë

Veprimtaria e sigurimit të brendshëm të cilësisë në UET udhëhiqet nga parime që garantojnë konsistencën, efektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve institucionale dhe akademike.

1. Përmirësimi i vazhdueshëm

UET angazhohet për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve akademike, administrative dhe mbështetëse, në funksion të rritjes së cilësisë institucionale dhe performancës së programeve të studimit.

2. Vendimmarrja bazuar në evidencë

Vendimmarrja institucionale dhe proceset e përmirësimit mbështeten në të dhëna, indikatorë, analiza dhe mekanizma monitorimi të besueshëm dhe të verifikueshëm.

3. Studenti në qendër (Student-Centred approach).

Sistemi i sigurimit të cilësisë mbështet zhvillimin e një mjedisi akademik të orientuar drejt studentit, rezultateve të të nxënit, mbështetjes akademike dhe përvojës studentore.

4. Transparenca dhe llogaridhënia

Proceset e sigurimit të cilësisë zhvillohen mbi bazën e transparencës institucionale, dokumentimit të proceseve, gjurmueshmërisë së vendimmarrjes dhe përgjegjshmërisë së strukturave përkatëse.

5. Pjesëmarrja e aktorëve të interesit

UET promovon përfshirjen aktive të studentëve, stafit akademik, alumni, punëdhënësve dhe aktorëve të tjerë të interesit në proceset e monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë.

6. Integriteti dhe besueshmëria e të dhënave

Proceset e sigurimit të cilësisë mbështeten në administrimin korrekt, ruajtjen, saktësinë dhe përdorimin e përgjegjshëm të të dhënave institucionale.

7. Përputhshmëria me standardet

Sistemi i sigurimit të cilësisë zhvillohet në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë, standardet kombëtare të sigurimit të cilësisë dhe Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG).

8. Qasja e integruar institucionale

Sigurimi i cilësisë konsiderohet përgjegjësi e përbashkët institucionale dhe realizohet përmes koordinimit ndërmjet strukturave akademike, administrative dhe drejtuese të universitetit.

9. Efektiviteti dhe orientimi drejt rezultateve

Proceset e sigurimit të cilësisë synojnë arritjen e rezultateve të matshme, efektivitetin institucional dhe përdorimin eficient të burimeve në funksion të zhvillimit akademik dhe institucional.

2.1. Standardet e sigurimit të cilësisë

Sistemi i sigurimit të cilësisë në UET zhvillohet në përputhje me Standardet e Udhëzuesit Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG) 2015, si edhe me standardet, kriteret dhe kërkesat e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me VKM Nr. 824, 24.12.2021, i ndryshuar.

Standardi 1. Politika për sigurimin e cilësisë.

Institucioni duhet të ketë një politikë për sigurimin e cilësisë e cila është bërë publike dhe është pjesë e menaxhimit strategjik. Palët e interesuara brenda institucionit duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë këtë politikë nëpërmjet strukturave dhe proceseve të përshtatshme duke përfshirë edhe palë të interesuara jashtë institucionit.

Standardi 2. Hartimi dhe miratimi i programeve.

Institucioni parashikon procese për hartimin dhe miratimin e programeve të studimit që ofron. Programet e studimit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të përmbushin objektivat dhe rezultatet

e të nxënit. Diploma e dhënë për programin e studimit duhet të përputhet me nivelin e kornizës kombëtare dhe asaj europiane të kualifikimeve.

Standardi 3. Të nxënët, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin.

Institucioni garanton se programet zhvillohen në mënyrë të tillë që nxisin studentët të luajnë një rol aktiv në krijimin e procesit të të nxënit dhe se vlerësimi pasqyron këtë qasje.

Standardi 4. Pranimi i studentëve, progresi, njohja e krediteve dhe diplomimi i tyre.

Institucioni duhet të paracaktosh dhe të publikosh rregulla për të gjitha fazat e "jetës studentore", pranimin, progresin akademik, njohjen e krediteve dhe diplomimin.

Standardi 5. Personeli akademik.

Institucioni duhet të garantojë cilësinë e personelit akademik. Institucioni duhet të zbatojë procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik.

Standardi 6. Burimet e të nxënit dhe mbështetja për studentin.

Institucioni duhet të ketë fondet e duhura veprimtaritë e të nxënit dhe të mësimdhënies dhe të garantojë se burimet e të nxënit dhe mbështetja për studentin janë të siguruar.

Standardi 7. Menaxhimi i informacionit.

Institucioni duhet të garantojë se mbledh, analizon dhe përdor informacionin e përshtatshëm për menaxhim efektiv të programeve dhe veprimtarive të tjera.

Standardi 8. Informimi i publikut.

Institucioni duhet të publikojë informacion për veprimtaritë që kryen, përfshirë programet e studimit, i cili duhet të jetë i qartë, i saktë, objektiv, i përditësuar dhe lehtësisht i arritshëm.

Standardi 9. Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i programeve.

Institucioni duhet të monitorojë dhe të vlerësojë periodikisht programet që ofron dhe të garantojë se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve dhe të shoqërisë. Këto vlerësime duhet të çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Veprimet e ndërmarra si rezultat i vlerësimit dhe përmirësimit duhet t'u komunikohen palëve të interesuara.

Standardi 10. Sigurimi i jashtëm ciklik i cilësisë.

Institucioni duhet t'i nënshtrohet sigurimit të jashtëm të cilësisë në baza ciklike në përputhje me standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe europiane.

KREU III

SISTEMI I SIGURIMIT TË CILËSISË


3.1 Organizimi i sistemit

- Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UET organizohet në nivel institucional, në nivel të njësive akademike dhe në nivel të njësive administrative e mbështetëse.
- Sistemi përfshin politikat, strukturat, procedurat, mekanizmat e vlerësimit, indikatorët, raportet dhe planet e përmirësimit që mundësojnë kontrollin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë.
- Funkcionimi i sistemit mbështetet në ndarje të qartë përgjegjësish ndërmjet Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, Rektoratit, NJSSC, njësive akademike, njësive administrative dhe strukturave të tjera përkatëse.

3.2 Qasja PDCA.

Qasja e sigurimit të cilësisë në Universitetin Europian të Tiranës bazohet në ciklin e përmirësimit të Deming, i njohur si cikli Plan-Do-Check-Act (PDCA), një qasje sistematike që çon në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë sipas skemës:

- Planifiko përfshin përcaktimin e objektivave të cilësisë, indikatorëve, afateve, strukturave përgjegjëse dhe planeve të veprimit për përmirësim.
- Zbato përfshin realizimin e proceseve, aktiviteteve dhe masave të planifikuara.
- Kontrolllo/vlerëso përfshin monitorimin, mbledhjen e të dhënave, analizën e rezultateve, përmes indikatorëve, raporteve, auditimeve dhe feedback-ut.
- Vepro/përmirëso përfshin marrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuese bazuar në rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit.



3.3 Qëllimet e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

- rritja e cilësisë së drejtimit institucional, mësimdhënies, të nxënit, kërkimit shkencor dhe shërbimeve mbështetëse;
- forcimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së UET me legjislacionin, Kodin e Cilësisë, standardet kombëtare dhe ESG;
- zhvillimi i programeve të studimit në përputhje me misionin institucional, nevojat e studentëve, kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet shkencore e profesionale;
- rritja e përfshirjes së studentëve dhe palëve të interesuara në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit;
- konsolidimi i kulturës institucionale të cilësisë dhe i përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e organizimit.

3.4 Objektivat kryesore të sistemit

- monitorimi i zbatimit të strategjisë institucionale, Statutit, rregulloreve dhe akteve të tjera të brendshme;
- monitorimi i ciklit të jetës së programeve të studimit, nga hartimi dhe miratimi deri te rishikimi, përditësimi, akreditimi ose mbyllja;
- vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, syllabuseve, metodave të vlerësimit, praktikave të provimeve dhe arritjes së rezultateve të të nxënit;

- ndjekja e performancës kërkimore-shkencore, artistike dhe profesionale të njëjësive akademike dhe stafit akademik;
- monitorimi i përfshirjes studentore, përvojës studentore, shërbimeve mbështetëse dhe punësueshmërisë së të diplomuarve;
- ndjekja e ndërkombëtarizimit, bashkëpunimeve akademike, mobiliteteve dhe projekteve institucionale;
- sigurimi i të dhënave të plota dhe të sakta për vendimmarrje institucionale dhe për procese akreditimi.

3.5 Dokumentet kryesore të sistemit

- Plani Strategjik i institucionit dhe dokumentet strategjike të zhvillimit;
- Rregullorja UET
- Strategjia për Sigurimin e Cilësisë;
- Manuali i Sigurimit të Cilësisë;
- plani vjetor i cilësisë;
- raportet e monitorimit, vetëvlerësimit dhe akreditimit;
- planet e përmirësimit dhe raportet e ndjekjes së tyre;
- instrumentet e mbledhjes së feedback-ut, formatet e raportimit dhe dokumentet e tjera mbështetëse.

3.6 Organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional

1. **Senati Akademik** është organi kolegjal më i lartë akademik i UET dhe përgjegjës për drejtimin, organizimin dhe garantimin e cilësisë së veprimtarisë akademike dhe kërkimore. Senati Akademik ka të drejtë të kërkojë çdo informacion dhe raportim nga strukturat akademike dhe administrative për çështje që lidhen me cilësinë. Në fushën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, Senati Akademik:
 - a) miraton politikat, strategjitë dhe aktet kryesore të sigurimit të cilësisë;
 - b) miraton rregullat dhe mekanizmat e monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë;
 - c) shqyrton raportet kryesore të cilësisë, raportet e vetëvlerësimit institucional dhe raportet e vetëvlerësimit të programeve të studimit;
 - d) miraton hapjen, rishikimin, pezullimin ose mbylljen e programeve të studimit, mbi bazën e evidencave akademike, treguesve të cilësisë dhe kërkesave të tregut;
 - e) mbikëqyr zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga proceset e vlerësimit, monitorimit dhe akreditimit;
 - f) garanton që vendimmarrja akademike të mbështetet në të dhëna, analiza dhe standarde të cilësisë;
 - g) promovon kulturën e cilësisë dhe përfshirjen e palëve të interesuara.
2. **Bordi i Administrimit** është organi më i lartë kolegjal administrativ i cili përbush disa përgjegjësi për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, si:
 - a) siguron që planifikimi buxhetor dhe administrativ të mbështesë objektivat institucionale të cilësisë;
 - b) mbështet me burime financiare, njerëzore, teknike dhe infrastrukturore proceset akademike, kërkimore, studentore dhe të akreditimit;
 - c) shqyrton çështje financiare ose administrative kur ato ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e sistemit të cilësisë;

- d) mbështet zbatimin e planeve të përmirësimit kur ato kërkojnë burime ose vendimmarrje administrative.
3. **Rektori** përfshihet në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si autoriteti më i lartë ekzekutiv që garanton zbatimin institucional të politikave, vendimeve dhe masave që lidhen me cilësinë. Në kuadër të sigurimit të cilësisë, Rektori:
- siguron zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik dhe të organeve të tjera kompetente për çështjet e cilësisë;
 - mundëson koordinimin ndërmjet strukturave akademike, administrative dhe mbështetëse;
 - ngre grupe pune ose grupe *ad hoc* për vetëvlerësim, akreditim dhe procese të tjera institucionale të cilësisë;
 - garanton që rekomandimet nga monitorimet, vetëvlerësimet dhe akreditimet të kthehen në masa konkrete për përmirësim;
 - siguron aksesin në të dhënat dhe evidencat e nevojshme për proceset e cilësisë.
4. **Prorektori për Procesin Mësimor dhe Cilësinë** koordinon në nivel institucional proceset që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, të nxënit, programeve të studimit dhe funksionimin e sistemit të sigurimit të cilësisë. Në fushën e sigurimit të cilësisë, Prorektori:
- koordinon zbatimin e politikave dhe strategjive të sigurimit të cilësisë;
 - mbikëqyr proceset që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, programeve të studimit dhe përvojës studentore;
 - ndjek zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimet e brendshme dhe të jashtme;
 - koordinon përgatitjen institucionale për proceset e akreditimit;
 - mbështet zhvillimin dhe rishikimin e programeve të studimit;
 - raporton pranë Rektorit dhe organeve drejtuese mbi ecurinë e proceseve të cilësisë.
5. **Njësia e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë (NJSSC)** është struktura institucionale përgjegjëse për zhvillimin, koordinimin teknik, monitorimin dhe mbështetjen e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UET. NJSSC ushtron funksionet e saj me pavarësi funksionale në analizë, vlerësim dhe raportim dhe i raporton drejtpërdrejt Rektorit dhe Senatit Akademik për çështjet e cilësisë. NJSSC bashkëpunon me Rektorin, Prorektorin për Procesin Mësimor dhe Cilësinë, njësitë akademike, njësitë administrative dhe strukturat e tjera të UET. Në ushtrim të funksioneve të saj, NJSSC:
- zhvillon dhe propozon politika, standarde, procedura dhe instrumente të sigurimit të cilësisë;
 - koordinon teknikisht proceset e monitorimit dhe vetëvlerësimit institucional dhe të programeve të studimit;
 - mbledh, përpunon dhe analizon të dhëna dhe indikatorë të performancës institucionale;
 - përgatit raporte analitike, raporte cilësie dhe dokumentacion për proceset e akreditimit;
 - mbështet njësitë akademike dhe administrative në vetëvlerësim, raportim dhe përgatitje evidencash;
 - monitoron zbatimin e rekomandimeve dhe planeve të përmirësimit;
 - kontribuon në zhvillimin dhe përditësimin e Manualit të Sigurimit të Cilësisë;
 - organizon informime, trajnime dhe aktivitete për zhvillimin e kulturës së cilësisë.
6. **Këshilli i Studentëve** është organ përfaqësues i studentëve dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë akademike, shërbimeve studentore dhe jetës institucionale. Në proceset e sigurimit të cilësisë, Këshilli i Studentëve:
- përcjell shqetësimet, nevojat dhe rekomandimet e studentëve;

- b) nxit pjesëmarrjen e studentëve në pyetësorë, fokus-grupe, konsultime dhe mekanizma të tjerë feedback-u;
- c) kontribuon në diskutimet për përmirësimin e programeve të studimit dhe shërbimeve studentore;
- d) bashkëpunon me NJSSC, Rektoratin dhe strukturat akademike për çështjet që prekin përvojën studentore.

7. **Grupet ad hoc të vlerësimit të brendshëm institucional** janë struktura të përkohshme që ngrihen me urdhër të Rektorit për realizimin e proceseve të vetëvlerësimit, veçanërisht në kuadër të akreditimit institucional. Përbërja e tyre siguron ekspertizë akademike, administrative dhe, sipas rastit, përfaqësim të studentëve ose përfshirje të palëve të tjera të interesuara. Grupet ad hoc mbledhin, verifikojnë dhe analizojnë evidencat, hartojnë raportin e vetëvlerësimit, identifikojnë pikat e forta dhe fushat për përmirësim, si dhe mbështesin përgatitjen për vlerësimin e jashtëm.

3.7 Organe, autoritete dhe struktura në nivel të njësive kryesore dhe bazë

1. **Njësiti kryesor (Fakultetet)** përfaqësojnë nivelin akademik ku zbatohen dhe monitorohen drejtpërdrejt politikat, standardet dhe procedurat e cilësisë për programet e studimit, mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet akademike. Në kuadër të sigurimit të cilësisë, njësiti kryesor, nën përgjegjësinë e Dekanit:
 - a) zbatojnë politikat dhe procedurat institucionale të cilësisë në nivel fakulteti;
 - b) monitorojnë programet e studimit, cilësinë e mësimdhënies, përvojën studentore dhe veprimtarinë kërkimore në fushat përkatëse;
 - c) analizojnë gjetjet nga pyetësorët, fokus-grupet, raportet e monitorimit dhe proceset e akreditimit;
 - d) hartojnë dhe ndjekin masa përmirësimi në nivel fakulteti, në bashkëpunim me njësiti bazë dhe NJSSC;
 - e) raportojnë pranë strukturave institucionale për ecurinë e cilësisë dhe zbatimin e rekomandimeve.
2. **Njësiti bazë / Departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore përfaqësojnë** nivelin operacional ku sigurohet cilësia e përmbajtjes akademike, zbatimit të programeve, rezultateve të të nxënit dhe veprimtarisë kërkimore ose artistike, sipas profilit të njësisë. Në kuadër të sigurimit të cilësisë, njësiti bazë, nën përgjegjësinë e drejtuesit të tyre:
 - a) sigurojnë përditësimin e syllabuseve, përputhjen e tyre me rezultatet e të nxënit dhe koherencën e përmbajtjes së lëndëve;
 - b) monitorojnë cilësinë e mësimdhënies, instrumentet e vlerësimit, rezultatet e studentëve dhe ecurinë akademike në programet përkatëse;
 - c) analizojnë nevojat për përmirësim në nivel lënde, grupi mësimor, programi ose fushe kërkimore;
 - d) propozojnë masa konkrete për përmirësimin e programeve, metodave të mësimdhënies, vlerësimit dhe zhvillimit akademik;
 - e) raportojnë pranë njësisë kryesore dhe bashkëpunojnë me NJSSC për evidencat dhe proceset e vetëvlerësimit.
3. **Përgjegjësi i Grupit Mësimor/ Koordinatori i programit të studimit** koordinon cilësinë e veprimtarisë mësimore brenda një fushe disiplinore dhe, sipas rastit, mund të ushtrojë edhe rolin e koordinatorit të programit të studimit. Në fushën e sigurimit të cilësisë:

- a) mbikëqyr hartimin, përditësimin dhe zbatimin e syllabuseve;
- b) siguron përputhjen e përmbajtjes së lëndëve me objektivat dhe rezultatet e të nxënit të programit;
- c) nxit përdorimin e metodave bashkëkohore dhe me në qendër studentin;
- d) monitoron cilësinë e detyrave, tezave të provimit dhe praktikave të vlerësimit;
- e) analizon rezultatet e studentëve dhe propozon masa për përmirësim;
- f) raporton pranë Drejtuesit të njësisë bazë për çështjet e cilësisë në grupin mësues.

3.8 Struktura ndihmës-akademike dhe administrative

1. **Njësitë ndihmës-akademike** mbështesin drejtpërdrejt veprimtarinë mësimore, kërkimore, studentore dhe zhvillimin akademik të institucionit. Njësitë ndihmës-akademike kontribuojnë në mbledhjen e të dhënave, përgatitjen e evidencave, mbështetjen e programeve të studimit, përmirësimin e shërbimeve studentore, ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit. Në këtë kategori përfshihen:
 - a) Zyra e Kurrikulave;
 - b) Biblioteka;
 - c) laboratorët mësimorë dhe kërkimorë;
 - d) Zyra e Projekteve dhe Ndërkombëtarizimit;
 - e) Zyra e Kujdesit ndaj Studentit;
 - f) Zyra e Këshillimit të Karrierës;
 - g) Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingut;
 - h) Zyra e Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe Statistikave në funksion të proceseve akademike;
 - i) Sekretaria mësimore.
2. **Njësitë administrative** sigurojnë funksionimin organizativ, financiar, njerëzor, teknologjik dhe mbështetës të institucionit. Njësitë administrative garantojnë saktësinë, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave institucionale, ofrojnë informacion për monitorim dhe akreditim, dhe mbështesin përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve. Në këtë kategori përfshihen:
 - a) Zyra e Burimeve Njerëzore;
 - b) Zyra e Financës;
 - c) Shërbimet Mbështetëse
 - d) Zyra e Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe Statistikave në funksion administrativ;
 - e) struktura të tjera administrative sipas organizimit të UET.

KREU IV

VLERËSIMI, MONITORIMI DHE PËRMIRËSIMI I CILËSISË

4.1 Parimet e monitorimit dhe vlerësimit

- Vlerësimi dhe monitorimi i brendshëm bazohen në objektivitet, paanshmëri, transparencë, besueshmëri të të dhënave dhe përgjegjshmëri institucionale.
- Proceset e monitorimit dhe vlerësimit synojnë identifikimin e pikave të forta, dobësive, rreziqeve dhe mundësive për përmirësim.
- Vlerësimi dhe monitorimi realizohen në mënyrë periodike dhe të dokumentuar, sipas Manualit të Sigurimit të Cilësisë dhe planit vjetor të cilësisë.

4.2 Organizimi i proceseve të monitorimit

- Proceset e monitorimit dhe vlerësimit organizohen në nivel institucional, në nivel fakulteti, departamenti, programi studimi dhe njësie administrative, sipas kompetencave përkatëse.
- Monitorimi përfshin analizën e programeve të studimit, mësimdhënies, kërkimit shkencor, përvojës studentore, shërbimeve mbështetëse, burimeve njerëzore, infrastrukturës, ndërkombëtarizimit dhe performancës administrative.
- Procedurat, instrumentet dhe afatet e monitorimit përcaktohen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë.

4.3 Indikatorët institucionalë të cilësisë. Indikatorët e vlerësimit të cilësisë dhe performancës përcaktohen në këtë strategji dhe përditësohen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Indikatorët kryesorë përfshijnë:

- a) numrin e studentëve, normat e regjistrimit, vijueshmërisë, kalueshmërisë, diplomimit dhe braktisjes;
- b) rezultatet e pyetësorëve studentorë, fokus-grupeve dhe formave të tjera të feedback-ut;
- c) përputhjen e syllabuseve me rezultatet e të nxënit dhe standardet e programit;
- d) performancën kërkimore, publikimet, projektet dhe aktivitetet shkencore;
- e) raportin staf/student, kualifikimin dhe zhvillimin profesional të stafit;
- f) mobilitetin, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe projektet e përbashkëta;
- g) punësueshmërinë dhe ndjekjen e të diplomuarve;
- h) cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve studentore dhe administrative;
- i) zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimet dhe akreditimet.

4.4 Fusha të vlerësimit të brendshëm në kuadër të sigurimit të cilësisë janë:

- Programet e studimit dhe mësimdhënia

Cilësia e programeve të studimit sigurohet nëpërmjet: përcaktimit të kriterëve të hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve, standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve, veprimtarisë aktive të Koordinatorit të Programit, zbatimit të sistemit të krediteve, vlerësimit dhe përmirësimit të syllabuseve, vlerësimit të mësimdhënies, rregullores së studimeve, cilësisë dhe personelit të kërkuar për mbulimin e ngarkesës të veprimtarive mësimore të programit, politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare, përdorimit të teknologjive bashkëkohore në mësimdhënie, sigurimit të fondit të teksteve sipas fushave të studimit në bibliotekë dhe aksesit në librari elektronike, infrastrukturës mësimore të përshtatshme, ndërkombëtarizimit të programeve, monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.

- Studentët dhe arritjet e tyre

Cilësia e studentëve sigurohet nëpërmjet: politikës dhe kriterëve të pranimit, politikës së vlerësimit të studentëve, politikës së mbështetjes dhe motivimit të studentëve (sistemi i bursave të ekselencës), kriterëve të vlerësimit të punimit të diplomës, treguesit për rezultatet e të nxënit, vlerësimit të nevojave të studentëve, treguesve të shërbimeve mbështetëse për studentët, rregullave për integritetin akademik, sistemit të verifikimit të plagjiaturës, treguesve të punësimit të të diplomuarve, mbështetjes së mobilitetit të studentëve, njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve.

- Personeli dhe performanca e tij

Cilësia e personelit sigurohet nëpërmjet: politikës së rekrutimit, përcaktimit të të drejtave dhe detyrave të personelit (përshkrimi i punës), standardet dhe treguesit e performancës, mbështetjes së mobilitetit, vlerësimit të nevojave, krijimit të kushteve të përshtatshme të punës, politikës së promovimit, politikës së zhvillimit profesional.

- Kërkimi shkencor

Cilësia e kërkimit shkencor sigurohet nëpërmjet: planit strategjik të kërkimit shkencor, kriterëve bibliometrike, të ndikimit, të infrastrukturës dhe ndërkombëtarizimit dhe treguesve përkatës, procedurës së monitorimit të treguesve dhe të vlerësimit të kërkimit shkencor, rregullores së etikës së kërkimit shkencor, sistemit të informimit për kërkimin shkencor.

- Shërbimet për studentët

Cilësia e shërbimeve në mbështetje të studentëve sigurohet nëpërmjet: rregulloreve të shërbimeve akademike dhe administrative ndaj studentëve, politikat për mbështetje dhe motivimin e studentëve (sistemi i bursave), vlerësimit të shërbimeve, zbatimit të masave për siguri, mbrojtje të shëndeti.

- Menaxhimi i Institucionit.

Cilësia e menaxhimit të veprimtarisë së Institucionit sigurohet nëpërmjet: politikës së zhvillimit institucional, kornizës rregullore të veprimtarisë, përmbushjes së misionit, menaxhimit të efektshëm të institucionit dhe të burimeve materiale dhe financiare, përmbushjes së standardeve të cilësisë, monitorimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së Institucionit, vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, akreditimit, politikës për menaxhimin e të dhënave, informacionit dhe burimeve njerëzore, sigurimit të burimeve të sigurta të financimit në përputhje me nevojat e Universitetit, kontrollit dhe auditit financiar, raportimit për menaxhimin e burimeve financiar.

4.5 Plani vjetor i cilësisë

- NJSSC, në bashkëpunim me Prorektorin për Procesin Mësimor dhe Cilësinë dhe strukturat përkatëse, harton planin vjetor të cilësisë.
- Plani vjetor i cilësisë përmban objektivat, aktivitetet, strukturat përgjegjëse, afatet, produktet e pritshme dhe treguesit e ndjekjes.
- Plani vjetor miratohet nga Rektori sipas procedurave të brendshme dhe shërben si dokument orientues për monitorimin, vetëvlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë gjatë vitit akademik.

4.6 Planet e përmirësimit

- Çdo proces monitorimi, vetëvlerësimi, akreditimi ose analizë cilësie që identifikon nevoja për përmirësim shoqërohet, sipas rastit, me plan përmirësimi.
- Plani i përmirësimit përcakton gjetjen ose rekomandimin, masën përkatëse, strukturën përgjegjëse, afatin, burimet e nevojshme, indikatorin e zbatimit dhe statusin e ndjekjes.
- Zbatimi i planeve të përmirësimit monitorohet nga strukturat përgjegjëse dhe ndiqet nga NJSSC në kuadër të raportimit periodik të cilësisë.

4.7 Dokumentimi dhe administrimi i të dhënave

- Proceset e monitorimit, vetëvlerësimit dhe përmirësimit dokumentohen në mënyrë të rregullt, të strukturuar dhe të verifikueshme.
- Strukturat përgjegjëse sigurojnë mbledhjen, ruajtjen, administrimin dhe aksesueshmërinë e të dhënave, duke respektuar saktësinë, integritetin, konfidencialitetin dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Administrimi i dokumentacionit realizohet sipas Manualit të Sigurimit të Cilësisë dhe rregullave të brendshme të UET.

KREU V

RAPORTIMI, TRANSPARENCA DHE ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE

5.1 Llojet e raporteve të cilësisë. Në kuadër të monitorimeve dhe vlerësimeve që kryhen, përgatiten raporte që pasqyrojnë nivelin e cilësisë dhe performancën e institucionit dhe të njëjësive përbërëse.

Raportet e cilësisë përfshijnë:

- a) raporte vetëvlerësimi institucional dhe të programeve të studimit;
- b) raporte monitorimi mbi programet e studimit, procesin mësimor dhe kërkimin shkencor;
- c) raporte mbi vlerësimin e mësimdhënies dhe përvojës së studentëve;



- d) raporte mbi ecurinë akademike, kënaqësinë studentore dhe shërbimet mbështetëse;
- e) raporte mbi performancën dhe zhvillimin profesional të stafit;
- f) raporte mbi të diplomuarit dhe punësueshmërinë;
- g) raporte mbi ndërkombëtarizimin, projektet dhe bashkëpunimet;
- h) raporte mbi efektivitetin e proceseve administrative;
- i) raporte mbi zbatimin e rekomandimeve dhe planeve të përmirësimit.

5.2 Linjat e raportimit

- Raportimi në kuadër të sigurimit të cilësisë realizohet në përputhje me strukturën organizative dhe linjat e autoritetit të UET.
- Strukturat në nivel fakulteti, departamenti, programi dhe njësie ndihmës-akademike dhe administrative raportojnë pranë autoriteteve përkatëse dhe, sipas rastit, pranë NJSSC.
- Raportet institucionale të cilësisë i paraqiten Prorektorit për Procesin Mësimor dhe Cilësinë, Rektorit dhe organeve drejtuese, sipas kompetencave përkatëse.
- NJSSC, si strukturë me pavarësi funksionale në raportim, paraqet raporte dhe analiza drejtpërdrejt në Senatin Akademik dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve drejtuese përkatëse.

5.3 Frekuenca e raportimit

- Raportimi i cilësisë realizohet në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme, në varësi të natyrës së procesit dhe sipas përcaktimeve në Manualin e Sigurimit të Cilësisë.
- Në raste të veçanta, raportimi mund të realizohet jashtë cikleve periodike, kur kjo kërkohet nga organet drejtuese, proceset e akreditimit ose nevojat e institucionit.

5.4 Aksesi, shpërndarja dhe publikimi i informacionit

- Informacioni dhe raportet e cilësisë janë të aksesueshme për strukturat përkatëse në përputhje me funksionet, përgjegjësitë dhe rregullat e brendshme të institucionit.
- Shpërndarja e informacionit realizohet në mënyrë të kontrolluar, duke garantuar saktësi, plotësi, konfidencialitet dhe përdorim të përshtatshëm për vendimmarrje.
- Institucioni garanton transparencën publike mbi programet e studimit, rezultatet kryesore të vlerësimit dhe treguesit e përgjithshëm të performancës, nëpërmjet kanaleve zyrtare dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.5 Përdorimi i rezultateve: Rezultatet dhe të dhënat e grumbulluara nga proceset e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera në kuadër të sigurimit të cilësisë, përdoren për:

- Planifikimin strategjik të UET;
- Përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit;
- Përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve, mësimdhënies, kërkimit, shërbimeve dhe menaxhimit;
- Planifikimin vjetor të veprimtarive në UET;
- Përmirësimin e performancës së personelit.

5.6 Arkivimi i raporteve dhe evidencave

- Raportet e cilësisë dhe dokumentacioni përkatës arkivohen në formë fizike dhe/ose elektronike, sipas rregullave të brendshme të UET.
- Arkivimi duhet të garantojë ruajtjen, integritetin, gjurmueshmërinë dhe aksesueshmërinë e dokumentacionit për qëllime monitorimi, vlerësimi, auditimi dhe akreditimi.
- Afatet e ruajtjes dhe procedurat e arkivimit përcaktohen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe në aktet e tjera të brendshme të institucionit.

KREU VI SIGURIMI I JASHTËM I CILËSISË DHE AKREDITIMI

6.1 Strukturat e sigurimit të jashtëm të cilësisë janë:

- autoritetet qeveritare:
 - Ministria përgjegjëse për arsimin
 - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe,
 - Bordi i Akreditimit (BA)
- agjenci të hapësirës europiane të sigurimit të cilësisë, pjesë e Rrjetit European të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (European Network of Quality Assurance, ENQA);
- autoritete audituese të pavarura;
- format të tjera të përfshirjes së ekspertëve të jashtëm në sigurimin e cilësisë.

6.2 Marrëdhëniet me ASCAL

- UET bashkëpunon me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.
- Komunikimi institucional me ASCAL koordinohet nga NJSSC nëpërmjet Drejtuesit të saj, në cilësinë e Koordinatorit Institucional për ASCAL, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.
- Marrëdhëniet me ASCAL përfshijnë proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, vlerësimet e jashtme, trajnime, takime konsultative dhe forma të tjera bashkëpunimi në fushën e cilësisë.

6.3 Koordinimi i proceseve të akreditimit

- Proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit koordinohen në nivel institucional, në përputhje me strukturën organizative, kompetencat dhe kërkesat e autoriteteve përgjegjëse.
- Strukturat përgjegjëse bashkëpunojnë për përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit, mbledhjen dhe verifikimin e evidencave, organizimin e vizitave të ekspertëve dhe ndjekjen e rekomandimeve.
- Organizimi i proceseve të akreditimit realizohet sipas legjislacionit në fuqi, udhëzuesve të ASCAL dhe Manualit të Sigurimit të Cilësisë.

6.4 Bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare

- Universiteti zhvillon bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë, organizata, rrjete dhe agjenci të sigurimit të cilësisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi synon shkëmbimin e praktikave të mira, zhvillimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e objektivitetit të vlerësimeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
- Me vendim të organeve përkatëse, universiteti mund të angazhojë ekspertë ose institucione të jashtme për vlerësime, trajnime, këshillime ose kontrole të jashtme të cilësisë. Përfshirja e vlerësuesve të jashtëm realizohet në përputhje me procedurat e brendshme, parimet e objektivitetit, konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit.

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Strategjia e Sigurimit të Cilësisë miratohet nga Senati Akademik dhe hyn në fuqi pas miratimit të saj.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Strategjie, shfuqizohet Strategjia e Sigurimit të Cilësisë 2023-2028, dhe çdo akt i mëparshëm institucional që rregullon sigurimin e cilësisë dhe bie në kundërshtim me të.

3. Në zbatim të kësaj Strategjie, UET harton, miraton dhe përditëson Rregulloren për funksionimin e Njësisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dokumente zbatuese për organizimin, funksionimin dhe procedurat e sistemit të sigurimit të cilësisë.
4. Ngarkohen për zbatimin e kësaj Strategjie Njësia e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, njësitë akademike dhe strukturat administrative të universitetit.

Miratoi

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. DRITA KRUJA



Universiteti
European i
Tiranës